



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:240271

Datë: 08.05.2024

Numri i dokumentit: 05663206

Në çështjen juridike të :

AC-I-23-0046-A0001

Paditëse

S S fshati V, Fushë Kosovë

Kundër:

E paditura/Ankuese

N.SH. K.B. “Drenica”, (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Shkelzen Sylaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0482, të datës 4 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 8 maj 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-15-0482, i datës 4 janar 2023.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 23 prill 2015, ankuesja ka parashtruar një kërkesë për rishikim të vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN011-0066 të datës 25 shkurt 2015, me të cilin vendim kërkesa e paditësit

për kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,477.00 euro, ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar kërkesa ishte parashkuar dhe nuk ka ndonjë dëshmi se paditësi e ka paraqitur këtë kërkesë në ndonjë gjykatë apo autoritet tjetër kompetent që nga janari i vitit 2010 kur kontrata e punës së parashtruesit ishte ndërprerë. Paditësi në kërkesë kishte propozuar që ta ndryshoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit, ashtu që të aprovohet kërkesa për rishikim si e bazuar dhe paditësit t'i kompensohen 7 pagat për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në emër të borxhit kryesor me rritje prej 10% në emër të kamatës në shumën prej 1,477.00 euro apo që të njëjtin ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim tek AL-ja.

Kërkesës i kishte bashkëngjitur provat si në vijim: një vendim për caktimin e kategorive të vendeve të punës dhe shkallës së koeficientit e datës 12 gusht 2002, konfirmimin për paditësen të datës 20 qershor 2014 nga N.SH K.B “Drenica”, listën me pranimin e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, autorizimin për përfaqësim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN011-0066 të datës 25 shkurt 2015 si dhe formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim të datës 15 korrik 2014.

Me datë 4 qershor 2021, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, e paditura kishte konsideruar se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent që nga janari i vitit 2010, kur kontrata e punës së parashtruesit ishte ndërprerë. Pra, AL kishte ardhur në përfundim se kërkesa për paga të papaguara është e parashkuar për arsye se parashtruesi nuk ka qenë në marrëdhënie pune me N.SH dhe nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim për të ndërprerë afatin e zbatueshëm të parashkrimit që nga janari 2010. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar.

Me datë 5 dhjetor 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për të paditurën nga e cila kishte kërkuar që të dorëzoj provat që paditësja ka dorëzuar pranë Autoritetit të Likuidimit të cilat shihen në formularin e kërkesës kreditore.

Me datë 16 dhjetor 2022, e paditura duke iu përgjigjur urdhrorit të gjykatës kishte dorëzuar këto prova në gjykatë: formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, një vendim për caktimin e kategorive të vendeve të punës dhe shkallës së koeficientit e datës 12 gusht 2002, konfirmimin për paditësen të datës 20 qershor 2014 nga N.SH K.B “Drenica”, listën me pranimin e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vendimin e ankimuar të AL-së, listën e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2005, regjistrin e punëtorëve të N.SH-së të cilët janë në marrëdhënie pune dhe marrin paga, regjistrin e punëtorëve që kanë punuar në ndërmarrje por tani nuk janë në N.SH, listën e punëtorëve të punësuar gjatë periudhës raportuese, regjistrin e punëtorëve të cilët janë të angazhuar me punë me orar të plotë dhe në orar të pjesshëm, listat e të ardhurave personale të papaguara për muajt janar-prill 2006, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së Sh S regjistrin e punëtorëve aktiv të NPBQ “Drenica” në Drenas, vendimin e emërimit të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses, një vendim për sistemimin e punëtorit në punë të datës 1 prill 2001 si dhe kopjen e librezës së punës së paditëses.

Me datë 4 janar 2023, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-15-0482 kishte aprovuar si pjesërisht të bazuar, ashtu që kishte ndryshuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit duke obliguar të paditurën që paditëses për dëmshpërblimin për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t’ia paguaj për 4 paga shumë prej 844.00 euro, me kamatë në lartësi prej 10%. Ndërsa, pjesën tjetër të kërkesës e kishte refuzuar si të pabazuar. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se gjykata kishte vlerësuar se paditëses nuk i është parashkruar kërkesa e saj kreditore dhe se të njëjtës i njihet e drejta në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Bazuar në faktin se paditësja kishte stazh pune 27 vite e 4 muaj, ndërsa sipas nenit 12 pika dh) dhe v) të Ligjit Themelor të Punës i vitit 2001 të njëjtës i takojnë 5 paga mujore, ashtu që në rastin konkret duke i marrë për bazë pagën mujore 211.00 euro, për katër paga është gjykuar shuma 844.00 euro. Andaj nisur nga vërtetimi i kësaj gjendje faktike dhe zbatimi i të drejtës materiale gjykata kishte aprovuar pjesërisht kërkesën si në dispozitiv, ndërsa ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesës.

Me datë 30 janar 2023, e paditura (ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-15-0482 të datës 4 janar 2023 (më tutje aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit të AL si të pabazuar dhe duke vërtetuar vendimin e AL. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe

atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëj me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëj me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar, vendimin e Autoritetit të Likuidimit si dhe vendimin për emërimin e anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 29 mars 2023, paditëses i ishte dërguar ankesa e AKP-së, mirëpo e njëjta nuk kishte parashtruar përgjigje.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditëses për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,477.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se e njëjta ishte konsideruar nga Autoriteti i Likuidimit si e parashkruar.

Paditësja në ankesën e saj në shkallë të parë të ushtruar kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, përveç që vazhdon të kërkoj kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, i njëjti i kishte bashkëngjitur edhe këto prova të shkresa të lëndës: një vendim për caktimin e kategorive të vendeve të punës dhe shkallës së koeficientit e datës 12 gusht 2002,

konfirmimin për paditësen të datës 20 qershor 2014 nga N.SH K.B “Drenica”, listën me pranimin e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, autorizimin për përfaqësim, vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN011-0066 të datës 25 shkurt 2015 si dhe formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim të datës 15 korrik 2014.

Gjithashtu e paditura AKP duke iu përgjigjur urdhrin të gjykatës, përveç provave të bashkëngjitura në ankesën e paditëses kishte bashkëngjitur edhe provat si në vijim: formularin për parashtrimin e kërkesës jo pronësore në likuidim, një vendim për caktimin e kategorive të vendeve të punës dhe shkallës së koeficientit e datës 12 gusht 2002, konfirmimin për paditësen të datës 20 qershor 2014 nga N.SH K.B “Drenica”, listën me pranimin e njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, vendimin e ankimuar të AL-së, listën e të ardhurave personale për muajin dhjetor 2005, regjistrin e punëtorëve të N.SH-së të cilët janë në marrëdhënie pune dhe marrin paga, regjistrin e punëtorëve që kanë punuar në ndërmarrje por tani nuk janë në N.SH, listën e punëtorëve të punësuar gjatë periudhës raportuese, regjistrin e punëtorëve të cilët janë të angazhuar me punë me orar të plotë dhe në orar të pjesshëm, listat e të ardhurave personale të papaguara për muajit janar-prill 2006, Njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së Sh S regjistrin e punëtorëve aktiv të NPBQ “Drenica” në Drenas, vendimin e emërimit të anëtarëve të Autoritetit të Likuidimit, njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses, një vendim për sistemimin e punëtorit në punë të datës 1 prill 2001 si dhe kopjen e librezës së punës së paditëses.

Shkalla e parë e DHPGJS-së, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditëses pjesërisht të drejtën në kompensim në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 844.00 euro me arsyetimin se e njëjta kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditëses si dhe në emër të interesit ligjor prej 10%, ndërsa pjesën e mbetur e kishte refuzuar si të pabazuar.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se, nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditëses i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë. Ky njoftim në përmbajtjen e tij theksonte se “shumat-pagat

që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”.

Prandaj, paditësja duke vepruar konform njoftimit që i është bërë, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

Edhe nga kopja e librezës së punës së paditëses shihet që të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës me privatizimin e ndërmarrjes në fjalë dhe atë me 1 nëntor 2006.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësja, pra për të vërtetuar faktin se paditëses nuk i takon dëmshpërblimi në fjalë dhe gjithashtu nuk e ka kontestuar as shumën e kërkuar nga ana e paditëses.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditëses i ka njohur të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 844.00 euro si dhe interesin ligjor prej 10%.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 15 shkurt 2023, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 8 maj 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
